



Funded by  
the European Union

## NGRITJA E VETËDIJES DHE BESIMIT TË QYTETARËVE NË INSTITUCIONET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

# Monitorimi i takimeve të KPK-së për periudhën janar – qershor 2023

Gjatë gjashtë-mujorit të parë të vitit 2023 (janar-qershor),  
Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka mbajtur gjithsej 6 takime


### 1 takim në muaj

1 Janar 1 Shkurt 1 Mars 1 Prill 1 Maj 1 Qershor

Këto takime janë monitoruar përmes platformës ZOOM.<sup>1</sup>



<sup>1</sup>Përkundër përpjekjeve tona për të monitoruar fizikisht mbledhjet, monitorimi është bërë online. Shih reagimin e Lëvizjes FOL  
<https://levizjafol.org/reagim-ndaj-mbylljes-dhe-mungeses-se-transparences-se-keshillit-prokurorial-te-kosoves/>



Për pesë takime të mbajtura, agjendat janë publikuar në kohë, ashtu siç është paraparë në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, përkatësisht në nenin 14 të tij<sup>2</sup>. Ndërkaq për takimin e mbajtur në muajin prill, agjenda nuk është publikuar fare.<sup>3</sup>

<sup>2</sup> Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës


<sup>3</sup> Ueb faqja kryesore e Këshillit Prokurorial të Kosovës, <https://prokuroria-rks.org/kpk>

**Të gjitha agjendat janë publikuar edhe në  
gjuhën shqipe, edhe në atë serbe.**

Shqip 5  
Serbisht 5

Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, është vërejtur se jo të gjithë anëtarët kanë qenë të pranishëm në takime. Më poshtë është paraqitur lista e anëtarëve të pranishëm dhe e atyre që munguan në takimet e KPK-së.

Të pranishëm Munguan



Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, 7 pika të rrethave të ditës të mbledhjeve të mbajtura kanë qenë të mbyllura për publikun. Vlen të theksohet se dy pika të rendit të ditës janë mbyllur në momentin e fundit pasi që ka filluar mbledhja e KPK-së.



29

Këshilli Prokurorial i Kosovës në ueb-faqen zyrtare të saj ka publikuar 29 vendime të nxjerra nga takimet e mbajtura.

Mesatarja e vonesave të fillimit të takimeve të Këshillit ka qenë 15 minuta. Në tabelën e mëposhtme është shfaqur për secilen mbledhje se sa është vonuar fillimi i takimeve.



Ndërkaq anëtarët më aktiv gjatë mbledhjeve të KPK-së për këtë periudhë gjashtë-mujore, të cilët kanë dhënë më së shumti kontribut në diskutimet e zhvilluara në këto takime, janë:



\*Shënim: Monitorimi përfshin anëtarët aktivë gjatë mbledhjeve të këshillit (të cilët diskutojnë dhe kontribuojnë mbi rendin e ditës të bazuar në agjendë). Qëllimi i publikimit të emrave është të stimulojë anëtarët e KPK-së që të kontribuojnë në diskutim gjatë mbledhjeve.